



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranuar - Prombëno Me Datën 15-06-2026			
Nr. Llogarit Org. Breg	Numri Breg	Shërbime Përbash.	Vlera Vendnost
07	170/05	601	



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d, neni 40.2 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenin 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-49, i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr.05/L-108 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Duke u bazuar në Ligjin Nr.10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, neni 8, te ndarja dhe rindarja e fondeve të bartura si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak, pika 2, bilancet e pashpenzuara të të hyrave vetanake të komunave, dhe pika 6 dhe 7 për bartjen e Buxhetit Komunal, nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më datën 15.06.2026, miraton këtë:

V E N D I M

për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2025 në vitin 2026

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për bartjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit 2025 në vitin 2026. Duke u bazuar në Ligjin Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, neni 8, te ndarja dhe rindarja e fondeve të bartura, si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak, pika 2, bilancet e pashpenzuara të të hyrave vetanake të komunave, dhe pika 6 dhe 7 për bartjen e Buxhetit Komunal në vlerë prej **303,855.75 €**, në vitin 2026. Nga vlera e mjeteve prej 303,855.75 €, mjete të bartura e të pashpenzuara nga viti 2025 janë prej **6,776.91 €** (të alokuara në kategori ekonomike dhe në programe sipas planit të buxhetit të vitit 2025), dhe rritje të buxhetit nga THV janë prej **297,078.84 €**.

Neni 2

Bartja e Buxhetit Komunal nga të hyrat vetanake komunale propozohen të shpërndahen në këto kategori ekonomike:

1. Mallëra e shërbime në shumë prej 559.28 €;
2. Subvencione e transfere në shumë prej 1,230.00 €;
3. Investime kapitale në shumë prej 302,066.47 €.

Të shpërndara në këto nën programe buxhetore:

Në kategorinë ekonomike, Mallëra dhe shërbime, shuma prej 559.28 €, në nën programet:

- Zyra e Kryetarit (16033), shuma prej 559.28 €

Në kategorinë ekonomike, Subvencione dhe transfere, shuma prej 1,230.00 €, në nën programin:

- Zyra e Kryetarit (16033), shuma prej 1,230.00 €

Në kategorinë ekonomike, Shpenzime kapitale, në projekte ekzistuese, shuma prej 302,066.47, në nën programet:

Buxhetimi (17533), shuma prej 297,078.84 €, në projektet:

- Participim i projekteve me donator, kodi (90552), shuma prej 297,078.84 €

Shërbimet e shëndetësisë primare (74950), shuma prej 4,987.63 €, në projektin:

- Renovimi i ambulantës në Viti, kodi (53893), në shumë prej 4,987.63 €

Arsyetim:

Në kërkesën për bartje të mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2025 në vitin 2026, të miratuara nga Kuvendi Komunal i Vitisë, nuk ka ndryshim në strukturën e shpenzimeve të mjeteve të mbetura, të pashpenzuara nga viti 2025.

Komuna ka tejkualuar (rritje) planin e të hyrave vetanake të vitit 2025 në vlerë prej 297,078.84 €, (buxheti i planifikuar ishte 1,270,127 €, kurse të hyra të mbledhura janë në vlerë prej 1.567,205.84 €) janë rritur kategoria e shpenzime kapitale në vlerë prej 297,078.84 €.

Bartja e të hyrave në vlerë prej **6,776.91 €**, kanë mbetur pa u shpenzuar nga viti 2025 në kategorinë:

1. Mallra e shërbime, vlera prej 559.28;
2. Subvencione e transfere, në vlerë prej 1,230.00 €;
3. Shpenzime kapitale, në vlerë prej 4,987.63 €.

Ndërsa, bartja e të hyrave në kategorinë e shpenzimeve kapitale në vlerë prej 302,066.47 €, në projektet e ekzistuese bëhet nga tejkalmimi i planit të shpenzimeve kapitale dhe mjete të pashpenzuara nga viti 2025 për pagesën e obligimeve në projekte të bashkëfinancimit, për të cilat kërkohej mjete shtesë të papaguara, të kryhen obligimet financiare.

- Participim i projekteve me donator, kodi (90552), shuma prej 297,078.84 € për pagesën e projekteve të bashkëfinancuara me donator.
- Renovimi i ambulantës në Viti kodi (53893), në shumë prej 4,987.63.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr.08/L284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave Nr.08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27 Dhjetor 2024), nenin 5, paragrafi 1, si dhe nenin 8, lidhur me nenin 9, paragrafi 1, të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave. dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare, në web faqe të Komunës së Vitisë.

Vendimi ju dorëzohet:

1. Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;
2. Zyrës së Kryetarit;
3. Shërbimit të Kuvendit; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

KRYESUESI

Bekim Azizi

